



RAPORT MONITORIMI
Nëntor 2020 – Janar 2021



Arti & Kultura

jashtë fokusit

AUTOR

Erisa Kryeziu


QENDRESA
QYTETARE



National Endowment
for Democracy
Supporting Freedom Around the World

www.qeverisja.qq.com.al

Arti dhe kultura (e pavarur) jashtë hartës së mbështetjes nga Qeveria gjatë 11 muajve pandemi



Pandemia e shkaktuar nga virusi COVID-19 për pak ditë bën një vit që ka kapluar Shqipërinë. Më 8 mars 2020, në Shqipëri u konfirmuan dy rastet e para me COVID-19, të cilët kishin ardhur nga Italia. Më 10 mars Shqipëria u fut në karantinë duke u pezulluar në këtë formë qarkullimi, dalja e lirë e qytetarëve përveç orareve të përcaktuara dhe thirrjet për higjienë personale dhe dezinfektim u shtuan më tepër në retorikën politike dhe institucionale.

Ashtu sikurse në të gjithë botën, kjo situatë erdhi me të papritura dhe të panjohura në fushën e shëndetësisë ku rregullat e ndryshuara në mënyrë të njëpasnjëshme diktonin jetën shoqërore pa krijuar një siguri për të ardhmen. Kjo situatë pandemike solli nevojën për vëmendje për të gjitha shtresat e shoqërisë në Shqipëri, qoftë në aspektin shëndetësor, por edhe në atë ekonomik, në kohën kur vendi kaloi në karantinë për dy muaj, 9 mars 2020-31 maj 2020, por edhe më tej.

Më 15 mars 2020 përmes një akti normativ të qeverisë shqiptare u sanksionuan një sërë rregullash dhe kërkohesh forcimi i zbatimit të tyre me qëllim parandalimin dhe luftimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

Një pikë e këtij akt-vendimi ishte edhe mbyllja e të gjitha veprimtarive kulturore dhe artistike në vend. Sipas vendimit kushdo që organizon një aktivitet kulturor apo sportiv duke çuar në grumbullime masive do të dënohej me pesë million lekë.

1“Subjektet apo individët që organizojnë zhvillimin e aktiviteteve publike dhe jopublike, si aktivitete sportive, kulturore dhe konferenca, apo grumbullimet masive në vende të mbyllura apo të hapura, si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike, dënohen me gjobë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë për organizatorët dhe ndalimin e aktivitetit”, -thuhej në aktin normativ.

¹ <https://www.asp.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/akt-normativ-2020-03-15-3.pdf>

Masat e ndërmarra bënë që aktivitetet të zhvendoseshin në një hapësirë tjetër, kësaj here atë virtuale. Kjo gjë u përqafua menjëherë nga insitucionet kulturore në vend, të cilat e zhvendosën punën e tyre online. Artistët dhanë shfaqje nga shtëpitë e tyre për audiencën që i ndiqte përmes faqeve zyrtare në rrjetin social Facebook ose Instagram, ndërsa më pas ata performuan edhe nga sallat e koncerteve apo teatrove, por pa publik. E vetmja formë për t'i ndjekur edhe në këtë rast ishte përmes rrjeteve sociale apo faqeve zyrtare ne internet të institucioneve kulturore dhe artistike.



Në një kërkesë drejtuar Ministrisë së Kulturës shikojmë që përgjatë periudhës mars-dhjetor 2020, numri i shfaqjeve të realizuara online apo edhe në skenë sipas insitucioneve artistike dhe kulturore janë të ndara në:

- Teatri Kombëtar, ka realizuar **40 shfaqje online**
- Teatri i Operas, Baletit dhe Ansambli popullor ka realizuar **47 shfaqje në skenë** dhe **8 online**
- Teatri Kombëtar Eksperimental ka realizuar **57 shfaqje skenike**.

Pra, për këto institucione nga muaji mars deri më dhjetor 2020 janë zhvilluar gjithsej **104 shfaqje në skenë** dhe **48 shfaqje online**.

Në këtë rast edhe pse në një situatë pandemike ku sallat e teatrove kanë qenë pa publik, puna ka vijuar duke e servirur artin në forma të tjera për të qenë më pranë publikut, sikurse është përmes internetit. Si rrjedhojë, artistët të cilët kanë qenë gjatë kësaj periudhe pandemie të punësuar në insitucionet kulturore dhe artistike kanë vijuar të marrin pagën e tyre mujore, sikur në një situatë normale.

Sipas një ²studimi të publikuar nga fondacioni gjerman në Shqipëri, Friedrich Ebert nën emërtimin "Bota e punës në kohë pandemie", **ndër sektorët më të prekur nga pandemia është edhe sektori i arteve, argëtimit dhe çlodhjes me 19.56 %**. Megjithatë, ndryshe nga sektorët e tjerë sipas studimit, Instituti i Statistikave (INSTAT) nuk ofron asnjë të dhënë sa i përket impaktit që pandemia pati në punësim në sektorin e arteve, argëtimit dhe çlodhjes.

² <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/16878-20201124.pdf>

Impakti i pandemisë mbi ekonominë dhe punësimin



(Burimi i grafikës: Studimi "Bota e punës në kohë pandemie" me autor Edlira Xhafa dhe Liri Kuçi, botuar nga fondacioni Friedrich Ebert)

Artistët e pavarur, pa asnjë mbështetje ekonomike prej muajit mars 2020

Teksa për një pjesë të konsiderueshme të profesioneve rikthimi pas karantinës dy mujore në procesin e punës ishte në mënyrë graduale e për disa edhe i menjëhershëm, për artistët shqiptarë të pavarur kjo gjë nuk ndodhi.

Përgjatë gjithë periudhës së karantinës, por edhe në vijim megjithëse u bë e mundur hapja e kafeneve, bareve dhe restoranteve nuk u lejua hapja e teatrove, lokaleve të natës si dhe organizimeve festive. Hapësira këto të cilat punësojnë për periudha të caktuara artistët e pavarur shqiptarë.

³Më 21 prill 2020, artistët e pavarur të gjendur pa asnjë mbështetje financiare nga shteti shqiptar dhe në kushtet ku nuk mund të ushtronin profesionin e tyre iu drejtuan Kryeministrit Edi Rama, përmes një letre publike. Artistë përfaqësues të disiplinave të ndryshme si filmi, teatri, artet pamore si dhe muzika i kërkuan qeverisë shqiptare mbështetje për këtë grupim meqë rifillimi i jetës sociale dhe artistike kërkon kohë.



³ <https://citizens-channel.com/2020/04/23/artistet-e-pavarur-kerkojne-perfshirjen-ne-ndihmen-financiare-nuk-mund-te-jetojme-pa-punuar/>

Letër e hapur Kryeministrit Edi Rama

Datë 21 Prill 2020, Tiranë

Nga artistë të sektorit të pavarur

I nderuar Zoti Kryeministër,

Ne që po ju drejtohem jemi artistë të Shqipërisë që e ushtrojmë profesionin në mënyrë të lirë.

Duke ju inkurajuar në punën që po bëni për të kapërcyer krizën si pasojë e Covid-19, ju sjellim në vëmendje që kjo krizë e thellë ka goditur edhe kategorinë tonë të artistëve që punojnë në sektorin jo shtetëror. Të ardhurat tona nuk vijnë në formën e një rroge mujore fikse, por në formën e shpërblimeve për pjesëmarrjen në projekte të ndryshme artistike. Paketat e ofruara të ndihmave ekonomike deri më sot nuk marrin në konsideratë në këtë moment shumë të vështirë artistët e pavarur, duke na lënë të papërfillur nga Qeveria.

Kuptojmë më së miri vështirësitë që pandemia Covid-19 i ka shkaktuar çdo sektori dhe limitet e buxhetit të Shtetit për të mbuluar të gjitha shtesat në nevojë. Por nuk mund të mos ngremë zërin tonë për faktin se qeveria juaj nuk po merr ende masa për të buxhetuar aktivitetin tonë, që zhvillohet në kushte jo të barabarta me sektorin shtetëror, por efektivisht mban gjallë skenën artistike të vendit. Ne jemi një numër i konsiderueshëm artistësh të pavarur të disiplinave të ndryshme (teatër, muzikë, danc, film, arte pamore) vazhdimisht aktivë në jetën artistike në të gjithë Shqipërinë, dhe jashtë saj duke funksionuar edhe si ambasadorë dinjitozë të kulturës shqiptare jashtë vendit.

Në këto kohë kur distanca fizike është ligj dhe kur mendohet që rifillimi normal i jetës sociale e artistike do të kërkojë shumë kohë (mbase deri në gjetjen e vaksinës), komuniteti ynë do ta ketë të pamundur të mbijetojë ekonomikisht. Ne duam të kontribuojmë për artin dhe kulturën në vendin tonë dhe nuk duam të emigrojmë, apo të detyrohemi të kërkojmë mënyra të tjera jetese, në pamundësi për të ushtruar profesionin për të cilin kemi investuar. Ndaj Shteti Shqiptar ka përgjegjësi për të mbështetur edhe kategorinë tonë në këto kohë krizike.

Ndërsa në vendet e tjera të Europës nevoja e veçantë për mbështetje për kulturën dhe artistët ka qenë ndër të parat që është adresuar, tek ne qeveria juaj pas më shumë se pesë javësh karantine dhe bllokimi të çdo aktiviteti artistik, ende nuk ka planifikuar përkrahjen financiare të këtij sektori, e konfirmuar edhe në deklaratat tuaja të fundit.

Ne e konsiderojmë të udhës që qeveria të ngrejë një fond të posaçëm për artistët e pavarur, të destinuar për ruajtjen dhe vazhdimësinë e iniciativës së lirë krijuese. Që komuniteti ynë të vazhdojë funksionin si faktor i domosdoshëm për jetën sociale dhe kulturore gjatë dhe pas krizës Covid-19, ka nevojë të përfillet në planet ekonomike sot.

Neni 11 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon trajtim të barabartë të sektorit publik dhe privat. Artistët e pavarur ofrojnë shërbime të barabarta me të punësuarit në sektorin publik, ndaj mbrohen me ligj.

Ju kujtojmë se ne kontribuojmë në buxhetin e shtetit në masën 15% të shumës së çdo shpërblymi të fituar, në formën e tatimit në burim.

Kjo nisim e jona ndërmerrtet nisur nga parimet që e bëjnë artin asetin më të rëndësishëm për ruajtjen dhe konsolidimin e identitetit kombëtar, forcon vlerat e demokracisë, edukon brezin e ri me vlerat kulturore europiane, nxit aktivizimin qytetar, zbat varfërinë, forcon kohezionin social, rrit punësimin në sektorin e artit dhe kulturës dhe bëhet faktor zhvillimi ekonomik e social.

Mbetemi në pritje të komunikimit të një zgjidhjeje. Momenti ka ardhur. Sot është pikërisht dita të merrni përgjegjësi dhe të jepni kontribut si Kryeministër i vendit në mënyrë që të mos diskriminohemi, të vazhdojmë të mbijetojmë ekonomikisht dhe profesionalisht që të japim kontributin tonë për artin dhe kulturën në vend edhe pas krizës aktuale.

Faleminderit

"Kuptojmë më së miri vështirësitë që pandemia COVID-19 ka shkaktuar cdo sektori dhe limitet e buxhetit të shtetit për të mbuluar të gjitha shtesat në nevojë. Por nuk mund të mos ngremë zërin tonë për faktin se qeveria juaj nuk po merr ende masa për të buxhetuar aktivitetin tonë, që zhvillohet në kushte jo të barabarta me aseptorin shtetëror, por efektivisht mban gjallë skenën artistike në vend. Ne jemi një numër i konsiderueshëm artistësh të pavarur të disiplinave të ndryshme (teatër, muzikë, danc, film, arte pamore) vazhdimisht aktivë në jetën artistike në të gjithë Shqipërinë dhe jashtë saj duke funksionuar edhe si ambasadorë dinjitozë të kulturës shqiptare jashtë vendit", - citonte letra e dërguar Kryeministrit Rama.

Referuar nenit 11 të Kushtetutës së Shqipërisë sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private dhe publike dhe në ekonominë e tregut të lirë. Si e fillë, privatja dhe publikja mbrohen njëllor me ligj. Artistët e pavarur shqiptarë edhe pse nuk janë të punësuar të përhershëm në një institucion publik apo privat sërish japin një kontribut të caktuar në buxhetin e shtetit, me 15% të shumës që ata fitojnë për çdo projekt artistik që kanë.

Qeveria shqiptare përgjatë periudhës së pandemisë hartoi dy paketa ndihmash që ndihmonin qytetarët në përballimin e COVID-19 në kushtet kur puna ishte ndaluar, apo punohej me orare të reduktuara.

⁴Në të dy paketat financiare “Anti-COVID-19” nuk u përfshinë në asnjë rast ndihma dhe vëmendja për artistët e pavarur në vecanti dhe për artin dhe kulturën në tërësi. Paketa e parë nën emërtimin ‘**Mbështetje për Biznesin e Vogël dhe Qytetarët**’ i ndau shërbimet e saj sipas këtyre zërave:

Masa 1 – ndihmë financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 000 000 lekë, për periudhën pas ndërprerjes së aktivitetit ekonomik për shkak të gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID19, duke përfshirë:

- personat fizikë të vetëpunësuar;
- punonjësit e papaguar të familjes të personit fizik tregtar;
- të punësuarit në personat fizikë tregtarë;
- të punësuarit në personat juridikë

Masa 2 – Dyfishim të pagesës për individët që përfitojnë pagesë të ndihmës ekonomike.

Masa 3 – Dyfishim të pagesës për individët që përfitojnë pagesën e të ardhurës nga papunësia.

Paketa e dytë e ndihmave nën emërtimin “**Mbështetje për Sipërmarrjen dhe Punëmarrësit**” i shpërndau ndihmat sipas këtyre zërave:

Masa 1 – Subvencionim për punonjësit e larguar + aktualë në bizneset me të ardhura 14+ milionë lekë të mbyllur nga urdhërat e MSHMS-së

Masa 2 – Mbështetje për të larguarit nga puna në periudhën 1 Mars – 17 Maj (për të gjitha subjektet e hapura apo të mbyllura nga urdhërat e MSHMS-së).

Masa 3 – Subvencionim për të gjithë punonjësit e bizneseve me të ardhura nën 14 milionë lekë (përfshijtur 8,000 persona në profesionet e lira, tregtia, farmacitë, përfituesit e pagës së luftës së Paketës 1, etj.)

Masa 4 – Subvencionimi i pagës së luftës për punonjësit e strukturave akomoduese në sektorin e turizmit.

Masa 5 – Mbështetje për punonjësit e Rafinerisë së Ballshit (Punonjës me pagë nën 100 mijë lekë/muaj)

Masa 6 – Ndihmë financiare për aplikuesit e ndihmës ekonomike, të cilët rezultojnë aplikues dhe nuk janë përzgjedhur nga sistemi i pikëzimit të ndihmës ekonomike

⁴ <https://financa.gov.al/raporte-per-covid-19/>

Në asnjë nga pikat e mësipërme nuk përmendet arti dhe kultura, ashtu sikurse nuk përfshihen as artistët e pavarur. Kryesisht paketat “anti-covid” janë përqëndruar te të papunët, bizneset dhe ata që nuk mund të punonin gjatë pandemisë. Në këtë qasje artistët e pavarur nuk bëjnë pjesë në asnjë nga grupet e mësipërme, kjo për faktin se ata nuk janë punonjës të përhershëm të një institucioni të caktuar, megjithëse për çdo projekt që realizojnë paguajnë 15% të pagës që marrin në buxhetin e shtetit.



⁵Nisur nga kjo gjendje, nga mungesa e vëmendjes së qeverisë shqiptare, por vecanërisht edhe nga mungesa e vëmendjes së Ministrisë së Kulturës, në 15 maj 2020 artistët organizuan një “aksion” me pankarta para Ministrisë së Kulturës ku kërkohet një përgjigje për situatën e tyre. Pas letrës së parë publike të artistëve adresuar Kryeministrit, ata patën një komunikim me ministren Elva Margariti, ku ju kërkua hartimi i një liste emërorë të numrit të artistëve të pavarur, me qëllim hartimin e një plani masash që do t’ju vinte

atyre në ndihmë. Pas këtij komunikimi nuk pati asnjë vijueshmëri se çfarë do të bëhej për artistët e pavarur.

Më 1 tetor 2020 Komiteti Teknik i Ekspertëve miratoi një protokoll të posaçëm për rihapjen e një sërë aktivitetesh si restorantet, bar kafetë, pishinat në ambiente të mbyllura etj.

“Komiteti Teknik i ekspertëve ka miratuar protokollet e posaçme të sigurisë për rihapjen duke filluar nga data 1 tetor të restoranteve dhe bar kafeve në ambiente të mbyllura si edhe pishinave në ambiente të mbyllura. Sjellim në vëmendje se do të vijojnë të mbeten të mbyllura bazuar në aktin normative të miratuar në muajin korrik të gjitha klubet e natës, pube, disko apo aktivitetet e tjera të këtij lloji”, - u shpreh ministria e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu.

⁵ <https://citizens-channel.com/2020/05/15/artistet-e-pavarur-aksion-prane-ministrise-se-kultures-kerkojne-pagen-e-luftes/>

Kjo masë u konsiderua e njëanshme nga artistët që performojnë muzikë live duke reaguar përmes rrejtëve sociale apo edhe daljeve publike në televizionet shqiptare.

Ata kërkuan rishikimin e protokollit anti-COVID-19 dhe vëmendjen e qeverisë shqiptare ndaj artistëve.

“Unë prisja që të kishte njëfarë kthim koke nga ana jonë sepse këtu ka filluar një lloj selektimi, ka filluar një lloj mbajtje me hatër. Po të bësh një xhiro nëpër rrugët kryesore të Tiranës sheh locale, të cilat buçasin nga muzika deri në orët e para të mëngjesit. Këtu fillon dyshimi nëse kjo gjë po behet me seriozitetin siç shprehen apo është thjesht një flluckë sapuni e cila për më tepër nuk jep as rezultatet në fund të fundit për sa i përket numrave”, - u shpreh artisti Renis Gjoka në një intervistë për News 24, teksa diskutoheshin pasojat e pandemisë të artistet përgjatë këtyre muajve.



⁷E ndërsa të tjerë artistë shkuan edhe më tej kur deklaruan se janë duke marrë kredi për të përballuar jetesën, për shkak të vështirësive ekonomike me të cilat po përballen. Një pjesë e konsiderueshme e tyre të ardhurat kryesore i kanë nga puna deri në orët e para të mëngjesit pranë klubeve dhe ambienteve të ndryshme argëtuese të natës.

6

https://www.youtube.com/watch?app=desktop&fbclid=IwAR12p2ojvajak5RPsVz0ziZtP8aaelu9fL9uJeX084XjfNZFjMkAM_rQE14g&v=fTMvqtAoFJA&feature=youtu.be

⁷ https://www.youtube.com/watch?app=desktop&v=yAwpg3V7-Y&feature=share&fbclid=IwAR0UG3SgGDZke7PnE-2sDp7SNDpgBr5AvbwqBZbVNBb_pARr03cfBka9PYw

⁸Në gusht 2020, pas vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë për vendosjen e maskave edhe në ambientet e mbyllura u miratua edhe akti normativ për ndalimin e muzikës pas orës 20:00. Kjo çoi në reagim të artistëve, të cilët kërkuan firmosjen e një peticioni që kërkonte nga qeveria një mbështetje financiare për këtë target grup që preket nga akti i miratuar. Mes kërkesave u kërkuar minimalisht 80% e pagës së munguar gjatë periudhës korrik-gusht 2020 për shkak të mbylljes së ambienteve të muzikës live.

Falimentimit të artistëve dhe mungesës së hapësirës ku ata mund të ushtronin profesionin e tyre për shkak të pandemisë, ministri Turizmit dhe i Mjedisit, Blendi Klosi iu përgjigj në shtator të 2020 në një intervistë televizive me argumentin se: ⁹“Në distanca ku ka valë muzike përhapja e muzikës është shumë e madhe”.

Pavarësisht kërkesave, peticioneve, letrave publike dhe takimeve me përfaqësues institucionalë, në muajin e 11-të të pandemisë dhe ndërprerjes së punës, artistëve të pavarur nuk ju është ofruar asnjë paketë ndihme ekonomike dhe asnjë plan konkret se si do të vijohet më tej me ta dhe punën e tyre.



Bledar Sejko

45 min · 👤

PETICION :

Ftojme te gjithe artistet,muzikante,kengetare,dj,performues dhe animatore,te bashkohen per mbijetesen e tyre dhe te familjeve si dhe per te drejten e ushtrimit te profesionit.

- 1.Propozoj regjistrimin ne shoqaten e Albautorit te te gjithe kategorive te lartpermendura
- 2.Perlogaritjen e datave te muguara duke qene se eventet zhvillohen ne nje periudhe 2 mujore dhe mesatarisht nje performues live performon 70 /80 evente ne baze vjetore ku 70% e tyre zhvillohen gjate muajve korrik gusht pra afersisht 50 evente
- 3.Pagesa mesatare per cdo event varion 15.000/20.000 leke per person keshtu qe fitimi i munguar shkon rreth 1milon leke te rinj ne te cilat plotesojme nevojat e familjeve tona
- 4.Kerkojme nga qeveria minimalisht 80%te pages se munguar per periudhen korrik/gusht
- 5.Kerkojme nje ligj ku te tutelohen te drejtat e artisteve dhe te profesioneve te lira,duke garantuar lirine e shprehjes dhe lirine e ushtrimit te profesionit

⁸ <https://citizens-channel.com/2020/07/20/covid-19-mbyllen-lokalet-e-nates-dhe-ndalohet-muzika-artistet-paralajmerojne-peticion-dhe-proteste/>

⁹ <https://www.youtube.com/watch?v=T-galTY2fwY&feature=share&fbclid=IwAR2UUO9Gqqwi2ra8EHJY4HWPIxPx7kVv-NBAEzejt8ZtCTqVRbkmiUR3rA>

Pandemia risolli në vëmendje nevojën për “statusin e artistit” dhe një kuadër ligjor të rregulluar

Për shkak të masave të ndërmarra për parandalimin e pandemisë COVID-19, prej afër 11 muajsh janë ndërprerë aktivitetet artistike dhe kulturore. Thirrjet e artistëve të pavarur për ndihmë nga ana e qeverisë shqiptare duket se deri më tani kanë rënë në vesh të shurdhër, për sa kohë ata nuk u përfshinë në dy paketat ndihmëse të qeverisë gjatë pandemisë, ashtu sikurse nuk pati asnjë program shtesë që t’ju vinte artistëve në ndihmë. Kjo çoi në reagime nga radhët e artistëve të pavarur të cilët mes kërkesës për mbështetje financiare parashtruan edhe nevojën për një kuadër ligjor që të mbronte të drejtat e artistëve dhe profesioneve të lira, të manifestuara këto edhe përmes miratimit të një statusi për artistin.

¹⁰Në vitin 2018 ish-ministrja e Kulturës Mirla Kumbaro u tërhoq nga iniciativa për miratimin e një projekt-ligji për artin dhe kulturën, pas kundërshtimeve nga artistët që deklaruan se duhet të uleshin edhe ata në diskutime për hartimin e tij.

Kjo problematikë u vu në pah edhe gjatë pandemisë, kur artistët e pavarur kërkuan mbështetje nga Ministria e Kulturës. Pas letrës së hapur drejtuar Kryeministrit më 21 prill 2020, Ministria kontaktoi grupin e artistëve të pavarur duke i vënë në dijeni se shqetësimi i tyre po shqyrtohej. Mes të tjerash ministrja i kërkoi grupit të mbledhje të dhëna dhe ti vendoste në dispozicion Ministrisë një “database” të numrit të artistëve të pavarur aktivë sa më shpejt.

Në këto kushte del në pah se Ministria e Kulturës nuk ka snjë informacion për artistët e pavarur. Sa janë në numër, çfarë zhanri të artit lëvrojnë dhe në ç’hapësira e lëvrojnë atë. Kjo gjë sigurisht e ka gjetur të pa përgatitur insitucionin e kultures per të hartuar politika dhe paketa në ndihmë të artistëve gjatë pandemisë. ¹¹Sipas ekspertëve juristë të fushës, përgatitja e një database të dhënash për artistët e pavarur është punë dhe detyrë e vetë ministrisë. Këto të dhëna ministrai i merr nga Ministria e Financave

¹⁰ <https://sot.com.al/kultura/kumbaro-t%C3%ABrhiqet-nga-prligji-p%C3%ABr-artin-dhe-kultur%C3%ABn-ligji-i-ri-do-t%C3%AB-hartohet-n%C3%AB-bashk%C3%ABpunim>

¹¹ https://www.youtube.com/watch?v=IC2-4Dlfpd0&t=886s&fbclid=IwAR10GWOAHa_r4bj2Y58hHNxICxxG4KCZYzm6KaG0Z5zugDaBIXOaWtbeHzg

apo edhe nga tatimet në varësi të kontributeve të artistëve. Më pas ministria i propozon një masë Këshillit të Ministrave.

¹²Më 28 maj artistët u pritën në takim nga ministrija Margariti, për kërkesat e tyre të iniciuara nga situatë e pandemisë COVID-19. Sipas artistëve të pavarur, në takim u parashtruan dy kërkesa kryesore:

1. Përfshirja e profesionistëve të lirë të sektorit të kulturës në paketat e ndihmës ekonomike në periudhën e ndalimit të aktiviteteve kulturore si pasojë e COVID-19.
2. Krijimi i një kuadri që do të lejojë profesionistët e lirë të kulturës me status të parregulluar të formalizohen dhe të regjistrohen nëpërmjet një skeme që mban parasysht specifikat e profesionit krijues.

Me gjithë këtë, pas këtij takimi nuk pati asnjë vijueshëmëri kontakti mes dy palëve dhe asnjë përgjigje për nevojat e artistëve të pavarur. Me mungesën e një database për artistët e pavarur Ministria e Kulturës nuk mund të hartojnë politika mbështetëse për artistët e pavarur, janë shprehur vazhdimisht artistët.

Artistët gjatë daljeve publike kanë sjellë në diskursin publik edhe nevojën për të pasur një status artisti. Ky status sipas tyre lind si nevojë për të siguruar mbrojtje në situata të tilla si pandemia, por edhe në moshën e pensionit apo si një garanci për vijueshmërinë e krijimtarisë së tyre.

¹³"Franca ka një status artisti që paguan për çdo artist që bën rreth 50-70 live në vit duke numëruar edhe live-t e lokaleve ka një status artisti që është një lloj asistence sociale 1900 euro në muaj kur merr këtë statusin artisti, që artisti të mos punojë po të dojë, por të ketë këto paratë e krijimtarisë",-sqaroi Bojken Lako për situatën e artistin në vendet evropiane.

¹² <https://www.facebook.com/Artist%C3%ABt-e-Pavarur-111271547226304>

¹³


https://www.youtube.com/watch?app=desktop&fbclid=IwAR12p2ojvajak5RPsVz0ziZtP8aeelu9fL9uJeX084XjfNZFjMkAM_rQE14g&v=fTMvqtAoFJA&feature=youtu.be

Mbështetja e vendeve të huaja ndaj artit dhe kulturës përgjatë pandemisë COVID-19

Arti dhe kultura pësuan një pushim të diktuar nga pandemia COVID-19 në të gjithë botën. Sheshet pa lëvizje, lokalet dhe restorantet e mbyllura e si rrjedhojë edhe muzika live në ambientet e natës u ndalua. Por në ndryshim nga Shqipëria, vendet e tjera evropiane i janë gjendur pranë artit në përgjithësi dhe artistëve të pavarur në veçanti. Kjo mbështetje ka ardhur duke krijuar fonde të vecanta emergjente, të cilat clirojnë artistët nga situata në të cilën janë ndodhur.



Për të krijuar një paralelizëm të situatës në Shqipëri me vendet e tjera sa i përket mbështetjes së artit dhe kulturës mjafton t'i hedhësh një sy Kosovës. Më 27 mars të vitit 2020 Zëvendës Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ylli Rugova njoftoi për publikun se do të ketë masa emergjente financiare me qëllim përkrahjen e sektorit të kulturës dhe rinisë.

 **Ylli Rugova**
27 March 2020 · 🌐

Në listën e masave të shumta nga [Ministria e Financave dhe Transfereve / Republika e Kosovës](#) për të ndihmuar qytetarët përballë vështirësive ekonomike të krijuara nga COVID-19 janë edhe masat për sport dhe kulturë. Pika 12 e masave thotë:

"Masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës kanë goditur rëndë edhe aktivitetet sportive, kulturore dhe artistike. Për të ndihmuar këto kategori, do të rritet për 5 milionë euro buxheti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, shumë kjo që do të përdoret për subvencionim shtesë të shoqatave sportive e kulturore të vendit."

I tërë aktiviteti sportiv dhe kulturor është pezulluar nga virusi COVID-19, sikurse edhe gjithë sferat tjera ekonomike e shoqërore andaj masat e tilla të Qeverisë janë parë si të domosdoshme. Me shumë informata rreth këtyre subvencione do të jepen edhe përmes formave të komunikimit të MKRS.

14Për këtë qëllim Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës do ti shtohet një fond prej pesë milionë euro.

"Masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës kanë goditur rëndë edhe

aktivitetet sportive, kulturore dhe artistike. Për të ndihmuar këto kategori do të rritet për 5 milionë euro buxheti i ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, shumë kjo që do të përdoret për subvencionim shtesë të shoqatave sportive dhe kulturore të vendit", -u shpreh Zëvendës Ministri i Kulturës në Kosovë.

Ndërkaq, përpos mbështetjes me fonde shtesë të Ministrisë së Kulturës në Kosovë, ndihma e veçantë ka qenë edhe për artistët e pavarur. 1,5 milion euro janë shpërndarë përmes subvencioneve për artistët e pavarur në Kosovë. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në Kosovë,

¹⁴ <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,2,851>

Vlora Dumoshi u shpreh në një ¹⁵intervistë për mediat se organizata dhe artistët e pavarur plotësojnë jetën kulturore në Kosovë. Duke i mbështetur ata në këtë kohë i bën të ndihen më të sigurt.

Për të shkuar më tej gjeografikisht, në javën e fundit të marsit të vitit 2020 Qeveria Federale gjermane ndërhyri me një paketë gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse për sektorët kulturorë dhe krijues të vendit. Referuar një njoftimi për shtyp që Ministria e Kulturës ndau në shtypin gjerman, mbështetja ndaj kulturës do të ishte prej një shifre 50 miliardë eurosh. Kjo shifër do të përfshinte në mënyrë të vecantë bizneset e vogla dhe profesionistët e pavarur, sigurisht mes tyre edhe nga sektorët kulturorë, krijues dhe mediatikë.



“Ne i dimë vështirësitë, ne e dimë dëshpërimin”, tha Ministra e Kulturës Monika Grütters në deklaratën e saj në lidhje me mbështetjen ekonomike ndaj kulturës dhe artistëve.¹⁶*“Sektori i kulturës në vecanti karakterizohet nga një pjesë e lartë e njerëzve të vetëpunësuar që tani kanë probleme me jetsën e tyre. Qeveria Federale është plotësisht e vetëdijshme për rëndësinë dhe idnustrive krijuese dhe ndihma po vjen sa më shpejt dhe me sa më pak burokraci të jetë e mundur”.*

Vetë kancelarja gjermane Angela Merkel e konsideroi artin dhe kulturën një pjesë shumë të rëndësishme të kombit dhe se do të sigurohej që jeta kulturore të kishte një shans në të ardhmen duke i mbështetur me programet ndihmëse.

¹⁷*“Pandemia e koronavirusit do të thotë tani një prerje e thellë në jetën tonë të përbashkët kulturore. Vecanërisht të prekur janë artistët, sidomos profesionistët e pavarur. Pasiguria dikton të tashmen. Dhe kjo është arsyeja pse qeveria federale është bashku me Landet federale dhe ministren e Kulturës Monika Grütters, janë të interesuar të sigurojnë që jeta jonë kulturore të vazhdojë të ketë një shans në të ardhmen dhe që vetë*

¹⁵ <https://www.vizionplus.tv/kosova-1-5-milion-euro-per-artistet-e-pavarur-ministria-dumoshi-ndihme-per-traumen-e-pandemise/>

¹⁶ <https://news.artnet.com/art-world/german-bailout-50-billion-1815396#.XnvA2DggEDA.facebook>

¹⁷ https://www.youtube.com/watch?v=IC2-4Dlfpd0&t=886s&fbclid=IwAR10GWOAHa_r4bj2Y58hHNxICxxG4KCZYzm6KaG0Z5zugDaBIXOaWtbeHzg


artistët të kenë një mundësi. Të dashur artistë, unë e di që ky është një moment shumë, shumë i vështirë për ju. Unë e di se sa na mungon dhe sa qytetarë presin të kthehen për të jetuar jetën kulturore. Deri atëherë, ne do të përpiqemi që t'ju mbështesim sa më shumë që të jetë e mundur me programet tona të ndihmës, duke ju bërë të kuptoni se sat ë rëndësishëm jeni për ne", -u shpreh Kancelarja Angela Merkel në një dalje publike.

Nga ana tjetër përvec mbështetjes qëndrore të qeverisë gjermane, qeveria e Berlinit u shpreh se kishte paguar më shumë se 1.4 miliardë dollar për më shumë se 150,000 individë të vetëpunësuar ose në biznese me nga më pak se pesë të punësuar. Të përfshirë në këtë paketë ishin edhe artistë, stilistë, programues kompjuterahs, krijues të ëeb-faqeve si dhe operatorë klubesh.

¹⁸Referuar deklaratave të kryera nga drejtuesit e qeverisë së Berlinit ky grup ishte shumë i vogël për tu kualifikuar në ndihmën fillestare të dhënë nga qeveria federale që kishte si qëllim mbajtjen në këmbë të biznesit të madh, kështu që qyteti u detyrua të krijonte vetë një paketë shpëtimi të destinuar posacërisht për ta.



Në Angli, një paketë emergjente prej 160 milion dollarë i ka ardhur në mbështetje artistëve dhe organizatave artistike të prekura nga situatë pandemike.¹⁹"Fondi shtesë ka për qëllim të shpëtojë organizatat e artit dhe vënia në veprim përfshin paketën prej 20 milion paund të krijuar për të mbrojtur jetesën e artistëve individual dhe profesionistëve të pavarur, të ardhurat e të cilëve janë goditur vecanërisht nga bllokimi i pjesshëm i vendit", - raporton Artnet News.



Pas mbylljes së muzeve, galerive, teatrove dhe vendeve të tjera kulturore shumë prej tyre janë përpjekur në ngazhimet për të paguar punonjësit e

¹⁸ <https://www.nytimes.com/2020/04/03/world/europe/coronavirus-Berlin-self-employed.html>

¹⁹ <https://news.artnet.com/art-world/arts-council-england-emergency-relief-fund-1814829>

tyre, ndërsa qeveria britanike ka mbështetur punëtorët me rrogë, por edhe artistët “freelance” dhe punonjësit e artit të cilët kanë humbur të ardhurat e tyre duke qëndruar në shtëpi.

Përfundime

Përgjatë 11 muajve të pandemisë së shkaktuar nga COVID-19 vëmendja ndaj artit dhe kulturës ka qenë e papërfillshme. Në asnjë dalje publike të Kryeministrit Edi Rama apo të Ministres së kulturës Elva Margariti nuk pati një kthim vëmendjeje se çfarë po ndodh me arti dhe kulturën. Të vetmet retorika publike kanë qenë të ministres Margariti e cila e ka paralelizuar situatën si të njëjtë në të gjithë botën, ku e rëndësishme fillimisht është shëndeti i njerëzve.

Artistët që punojnë në institucione shtetërore si Teatri i Operas, Baletit dhe Ansabli popullor, Teatri Kombëtar, Teatri Eksperimentar, Teatri Metropol apo në institucione të tjera private të artit dhe kulturës, vijuan punën e tyre artistike, por në formatin online. Në rastet kur performancat u realizuan në skenë, ato ishin pa shoqërinë e publikut.

Në ndryshim nga artistët që ishin të punësuar edhe përgjatë pandemisë, ka një grup shumë të madh artistësh të cilët punojnë si të pavarur. Për këta artistë Ministria e Kulturës nuk ka një bazë të dhënash me numrin e tyre në të gjithë Shqipërinë, me zhanret e arteve të tyre dhe se ku performojnë. Detyrën për t'i mbledhur këto të dhëna, që l takon Ministrisë së Kulturës ajo ia delegoi vetë artistëve teksa këta të fundit kërkonin mbështetje financiare.

Artistët e pavarur janë grupi më i diskriminuar përgjatë pandemisë COVID-19, pasi nuk kanë qenë pjesë e asnjë pakete ekonomike të bërë publike nga qeveria shqiptare, ashtu sikurse nuk kanë qenë pjesë e asnjë iniciative të vetë Ministrisë së Kulturës. Kjo, edhe për faktin se Ministria e Kulturës përgjatë pandemisë COVID-19 nuk ka pasur asnjë paketë mbështetëse për artistët.

Artistët e pavarur janë ndjerë të braktisur nga shteti tek i cili janë kontribues në buxhet me 15% të pagës së tyre për çdo projekt që realizojnë. Megjithatë gjatë pandemisë nuk rezultuan as të punësuar dhe as të papunë.

Retorikat e artistëve përgjatë 11 muajve pandemic janë orientuar drejt nevojës për hartimin e një ligji formalizues për artin dhe kulturën e pavarur

dhe për nevojën për të pasur një status artisti, me qëllim mbrojtjen e tyre për çdo situatë të pazakontë shëndetësore, natyrore dhe për të vijuar artin e tyre.

Në ndryshim nga Shqipëria, vendet e tjera, duke nisur nga Kosova dhe deri te vendet evropiane arti dhe kultura dhe veçanërisht artistët e pavarur kanë qenë në vëmendjen shtetërore duke i përfshirë në paketa mbështetëse ekonomike, fonde të posacme për artistët, apo edhe duke cuar qeveritë në vendimin për të rritur buxhetin e kulturës. Gjë e cila nuk ka ndodhur në Shqipëri, pasi më shumë rëndësi i është dedikuar Ministrisë së Shëndetësisë në rritjen e buxhetit, për shkak edhe të specifikës së pandemisë.

Rekomandime

- Ministria e Kulturës duhet të krijojë një “database” të artistëve të pavarur në vend sa më shpejt të jetë e mundur dhe t'i ftojë ata në diskutime konkrete për të kuptuar më qartë situatën në të cilën ndodhen dhe vështirësitë përgjatë vitit të fundit.
- Ministria e Kulturës në bashkëpunim me qeverinë shqiptarë duhet të hartojnë një paketë ekonomike të dedikuar për artistët e pavarur që ju vjen në ndihmë atyre, apo ti dëmshpërblejnë për të gjithë muajt që nuk kanë punuar si pasojë e akteve normative që kanë mbyllur ambientet ku lëvrohet art dhe kulturë.
- Duhet të ketë një iniciativë nga Ministria e Kulturës në bashkëpunim me artistët për të hartuar bashkarisht një projek-ligj që saktëson rolin e artistëve të pavarur, formalizon dhe mbron ata në tregun e punës. Kjo gjë mund të vijë në bashkërendim edhe me formalizimin e një statusi për artistin sipas praktikave dhe eksperiencave më të mira evropiane.

#QËNDRESË MIRËQEVERISJE



www.qeverisja.qg.com.al

RAPORT MONITORIMI

Arti & Kultura

Nëntor 2020 - Janar 2021